



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1453 Prot.

Tiranë, më 26. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 147 , Datë 26. 10. 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr. 6 regj, datë 23.01.2020, që i përket ankuesit E. N., kundër Zyrës Vendore Arsimore Klos² dhe Shkollës 9-vjeçare “*Tahir Hoxha*” Klos, me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe bindjeve politike. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar, ankuesi ka parashtruar se:

Në vitin 1984 kam përfunduar studimet në Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi” Tiranë, Dega Frëngjisht. Kam vazhduar në vitin 1985 Universitetin e Histori Filologji, Dega Frëngjisht deri në vitin 1986. Më 01.09.1986 - 31.08.1987 jam emëruar mësues Gjuhë Lexim në Shkollën 8-vjeçare Peshk, Martanesh. Në datë 01.09.1987 jam rikthyer në Universitet për të vazhduar studimet e larta deri më 31.08.1988. Në vitin 1989-1991 kam kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe më datë 01.09.1992 jam emëruar mësues në Shkollën 8 vjeçare Dars-Klos, ku kam punuar deri më datë 31.08.1993. Nga data 01.09.1993 deri më 31.08.1998 kam punuar mësues i gjuhës frenge në Shkollën 8-vjeçare Klos dhe nga 15.09.1999 deri më datë 31.03.2001 kam punuar në Shkollën e Mesme Suç. Në prill 2001 deri në mars 2004 kam qenë në marrëdhënie pune në Bashkinë Klos dhe në shkurt 2005 deri në prill 2007 kam punuar mësues Gjuhë-Leximi, në Shkollën 8-vjeçare Bejn, Klos. Në vitin 2009 kam rifilluar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja me kohë të plotë dhe kam përfunduar studimet në Bachelor në vitin 2011, Dega Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Freng.

Me datë 01.09.2011 emërohem mësues në Shkollën 9-vjeçare “Dyle Cela” Patin-Klos deri më datë 31.08.2014 dhe më datë 01.09.2014 emërohem mësues i Gjuhës Frengje në Shkollën 9-vjeçare

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ZVA Klos.

“Tahir Hoxha” Klos deri më datë 06.01.2020, kur jam larguar nga puna. Sqaroj faktin se kam 22 vite punë në arsim, kategoria e dytë e fituar.

Rezulton e provuar nga dokumentacioni (shkresa nr.15 prot, datë 05.10.2018, lëshuar nga Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, se unë kam vazhduar të jem mësues i emëruar sipas listës me nr.rendor 17 deri më datë 06.01.2020 kur jam detyruar që të ndërpresë marrëdhëniet e punës dhe financiare. Gjatë periudhës në mësimdhënie nuk kam patur thyerje të disiplinës në punë, si dhe kam zbatuar me korrektësi të gjitha udhëzimet dhe ligjet në fushën e arsimit. Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos edhe pse nuk ka patur vërejtje nga puna ime në vite, me shkresën nr. 47 prot., datë 06.01.2020 më ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe financiare me motivacionin se nuk kam arsimin përkatës universitar. Arsytet dhe qëllimet e drejtuesve të subjekteve të mësipërm nuk i kam kuptuar deri në momentin që më kanë vënë në dispozicion shkresën nr. 47 prot., datë 06.01.2020 për largimin tim nga puna, shkresë e cila për mua është një diskriminim që më është bërë nisur nga faktet që po parashtroj më poshtë:

Në vendimin nr.05, datë 30.09.2019, në pikën 2, Zyra Vendore Arsimore (ZVA) Klos thekson: *“Të refuzojë miratimin e listës emërore të mësuesve të Shkollës “Tahir Hoxha” në Klos, me nr.rendor 20,22,23 për të qenë të emëruar në vendet e punës, pasi bien ndesh me Ligjin nr. 69/2012, si dhe urdhrin nr. 363, datë 16.09.2014.”*

Sipas shkresës nr.17 prot., datë 25.09.2019 e lëshuar nga Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” rezulton se mësuesit me nr.rendor 20,22, 23 sipas këtij vendimi dhe organikës janë : A.L, E.N (ankuesi) dhe E.Sh. Mësuesit me numrin rendor 20 dhe 23 japin mësim në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” në Klos si dhe kanë përfunduar arsimin si ankuesi (Bachelor). A. L. (mësuesi me nr.rendor 20), aktualisht jep mësim në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos për lëndën e edukimit fizik dhe ka përfunduar arsimin Bachelor për degën e edukimit fizik; E.Sh (mësuese me nr.rendor 23), aktualisht jep mësim në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, cikli i ulët, arsimin DNP (Bachelor). Në këto kushte mësuesit me nr.rendor 20,23 që kanë mbaruar bachelorin në kushte të njëjta arsimore, përsëri vazhdojnë të japin mësim dhe pse në pikën 2, të vendimit nr. 5, datë 30.09.2019 duhet të ishin larguar nga puna për kriteret e arsimit, kurse unë që kam mbaruar arsimin e mesëm profesional, bachelorin dhe kategorinë e dytë, largohem nga puna.

Në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, rezulton se disa mësues nuk plotësojnë kriteret për vendin e punës në bazë të nenit 57, të ligjit nr. 69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si vijon: I. B., mësues muzike, në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, O.P, prej dy vitesh nëndrejtoreshë shkolle, D. H., mësuese e arsimit fillor, E.M, mësuese e arsimit fillor, emëruar N/Drejtoresh në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, M.M, mësuese e gjuhës angleze.

Në këto kushte, unë si ankues jam diskriminuar nga T.K, Drejtoresh e ZVA Klos dhe F.N, Drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre gjatë ushtrimit të detyrës si drejtues institucionesh më kanë sjellë pasoja të pariparueshme, në shëndetin tim, në ekonomikë time familjare, në opinion, duke më larguar nga puna në kundërshtim me çdo kriter, udhëzim apo ligj në fushën e arsimit, ndërkohë që siç është theksuar më lart emërohen dhe

mbahen në punë mësues pa kritere dhe pa arsimin përkatës, si dhe me kritere arsimi dhe shkollë më të ulët se atë të kryer nga ana ime.

Këto veprime bien ndesh me nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Nga analiza e rasteve të përmendura më lart është i vërtetë fakti se unë si ankues kam patur pengesa dhe pamundësi të ushtrimit të të drejtës sime themelore atë të detyrës sime si mësues me të njëjtën mënyrë si kolegët e mi mësues.

Në përfundim ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rikthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjendjen arsimore dhe bindjet politike, pretenduar nga ankuesi si shkaqe diskriminuese (neni 1⁴). Neni 3, i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c⁵, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, *bazuar në gjendjen arsimore dhe bindjet politike*, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu *pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

⁴ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore**, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo **lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr.119/2 prot., datë 05.02.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Zyra Vendore Arsimore Klos dhe Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.
- Me shkresën nr.54/1 prot., datë 27.02.2020⁶, Zyra Vendore Arsimore Klos ka kthyer përgjigje, duke parashtruar:

Nga data 25 -29.09.2019 të gjitha drejtoritë e shkollave, kanë sjellë për miratim në ZVA, organikën e mësuesve të tyre. Më datë 30.09.2020 bazuar në email-in e datës 27.09.2019 do të dërgonim në DRAP Durrës tabelën e organikave mësimore sipas shkollave. Në dokumentacionin e sjellë nga Drejtori i Shkollës “Tahir Hoxha” Klos mbi organikat dhe listën emërore të mësuesve me nr. 17 prot., datë 25.09.2019, mësuesi E.N.N figuron me vendim bazuar në emërimin e vitit 2014. Në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, mësuesi në fjalë është emëruar nga 1 shtator 2014 si mësues në profilin Gjuhë Frënge, me arsim të mesëm të gjuhëve të huaja në Shkollën “Asim Vokshi” Tiranë në vitin 1984 dhe Diplomë Bachelor në Gjuhë Frënge në vitin 2011 në Universitetin e Tiranës. Mësuesi në fjalë ka 22 vite punë si mësues i Gjuhës Frënge dhe zotëron shkallën e 2-të të kualifikimit.

Ne si ZVA, konstatuam mospërputhje të emërimit të tij në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar më Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrit nr.363, datë 16.09.2014 “*Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në arsimin parauniversitar*”. Më datë 30.09.2019, me vendimin nr.5, të ZVA Klos, refuzuam miratimin e listës emërore të paraqitur për miratim nga drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, duke ngarkuar drejtorin e shkollës që në bazë të akteve ligjore të mësipërme të marrë masa për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas kërkesave dhe procedurave në Kodin e Punës. Po në datë, 30.09.2019 na vjen dhe një ankesë nga Portali i Bashkëqeverisjes “Shqipëria që duam” nga një mësuese (A.Ll) e cila pretendonte se ka mësues të profilit gjuhë frënge pas arsim përkatës. E njëjta ankesë na vjen nga portali dhe nga një mësuese tjetër (L.L) më datë 08.10.2019. Më datë 16.10.2019, nga MARS dërgohet me e-mail në adresën e DRAP Durrës që të jepej një përgjigje përfundimtare. Përgjigja e DRAP Durrës ishte: “*Mësuesi i gjuhës frënge në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos z. E.N, nuk përmbush kriteret ligjore për të ushtruar profesionin e mësuesit (ligji 69/2012, neni 57 “Profesioni i mësuesit”), në këto kushte në bazë të ligjit nr. 7961, Kodi i Punës. Drejtori i institucionit arsimor do fillojë procedurat e largimit nga detyra.*”

Sipas rekomandimeve të DRAP Durrës, pas inspektimit të bërë prej tyre, drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos ka bërë njoftimin e mësuesit më datë 09 tetor 2019 për nisjen e

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.370/1 prot., datë 02.03.2020.

procedurave për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Për këtë është mbajtur dhe një procesverbal me datë 11 tetor 2019. Mësuesi është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës më datë 07.01.2020, pasi është zbatuar Kodi i Punës për një afat 3 muaj për punonjësit që kanë mbi 5 vite punë. Mësuesi E.N është liruar nga detyra pas mbarimit të afatit tre muaj të njoftimit, me datë 06.01.2020 dhe më datë 07.01.2020 ky vend është shpallur vakant. Prej 2 mësuesëve të portalit, ankuesja A.Ll është nga portali “Mësues për Shqipërinë” dhe sipas udhëzimit nr.13, datë 22.05.2019, pas shpalljes së vendit vakant, si e para (dhe e vetmja) në portalin “Mësues për Shqipërinë” në ZVA-në tonë, ky vend pune i ofrohet asaj, ndërsa mësuesit E.N i ofrohet me kontratë me afat, vendi i punës si mësues në shkollën 9-vjeçare “Ramiz Kadiu”, Bejn (si vendi i vetëm që kemi për t’i ofruar). Ai nuk e ka pranuar këtë variant. Sa i përket parashtrimeve të ankuesit për mësuesit A.L, E.Sh, M.M, I.B, O.P, D.H dhe E.M, se emërohen dhe mbahen në punë mësues pa kritere, si dhe me kritere arsimore më të ulëta se ai, bie poshtë dhe përgenjështrohet nga faktet dhe provat e bashkëngjitura.

Sa i përket ankesës që është objekt diskriminimi kjo është absolutisht e pavërtetë sepse E.N bazuar në bazën ligjore të cituar më sipër nuk i përmbush kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit gjë që rrëzon parashtrimin e tij se është diskriminuar.

- Me shkresën nr.61 prot., datë 11.02.2020⁷, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos ka kthyer përgjigje, duke parashtruar:

E.N.N, ish mësues i Gjuhës së huaj frënge në AMU, nisur nga dosja e tij profesionale që ka dorëzuar në drejtori të shkollës, gëzon këtë nivel arsimor: Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja “A.Vokshi”, Tiranë 1994; Bachelor në Gjuhën Frënge-Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Frëng, UT, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë 2011; 22 vite punë në arsim. E.N.N rezulton mësues i Gjuhës së Huaj Frënge, pa diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare dhe për rrjedhojë pa licencë si mësues i Gjuhës Frënge, në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 57, me urdhrin nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në Institucionet Publike të Arsimit Parauniversitar”, pika 3, me Kontratën Kolektive të Punës Nr. 6145 prot., datë 05.06.2018, Neni 4, pika 4.3-b.

Vendimi nr.13, datë 06.01.2020 “Për lirim nga detyra të z. E.N”, ka shkak ligjor zbatimin e ligjit nr.69/2012 nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 57, pika 1, b, zbatimin e urdhrin nr.363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në Institucionet Publike të Arsimit Parauniversitar”, pika 3, zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës Nr. 6145 prot., datë 05.06.2018, Neni 4, pika 4.3-b, zbatimin e vendimit nr. 5, datë 30.09.2019 të ZVA Klos. Në fakt ankuesi E.N.N ka marrë deri tani gjatë arsimimit të tij vetëm diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve universitare bachelor dhe për pasojë nuk i është nënshtruar provimit të shtetit. Ai do të ruante vendin e punës vetëm nëse në zbatim të nenit 72 të ligjit 69/2014 do të kishte fituar tri shkallët e kualifikimit.

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.370 prot., datë 02.03.2020.

Vendimi nr.13, datë 06.01.2020 “Për lirim nga detyra të z. E.N”, është marrë konform kuadrit ligjor institucional në fuqi, duke e njoftuar më parë për shkakun e këtij largimi. Bazuar përveç të tjerash në Kontratën Kolektive të Punës nr.6145 prot., datë 05.06.2018, neni, pika 4.8 dhe në Kodin e Punës, Kreu XIV “Kohëzgjatja e kontratës së punës”, paditësi është njoftuar tre muaj para se të merrej vendimi për lirim nga detyra. Më datë 07.10.2019 përmes urdhrorit të brendshëm të drejtorisë së shkollës nr.24 prot datë 07.10.2019 “Për nënshkrimin e kontratës së punës nga punonjësit arsimorë për vitin shkollor 2019-2020”, në zbatim të vendimit nr.5, datë 30.09.2019 të ZVAP Klos, punonjësit me nr.rendor 20,22,23 të listës organike, u bëhet thirrje për të nënshkruar me datë 07.10.2019 kontratën individuale të punës me afat të caktuar. Më datë 09.10.2019 ankuesi është thirrur në drejtorinë e institucionit arsimor ku është njohur dhe dhënë një kopje e shkresës zyrtare me nr.28 prot., datë 09.10.2019 “Njoftim për paraqitje në drejtorinë e shkollës Tahir Hoxha, Klos”, ku i bëhet me dije se duhet të paraqitet me datë 11.10.2019, 72 orë pas marrjes së njoftimit në drejtorinë e shkollës, për të biseduar rreth ndërprerjes së kontratës së punës. Me datë 11.10.2019 ankuesi paraqitet në drejtorinë e institucionit arsimor ku në prani të tij, mbahet procesverbal. Në këtë procesverbal është pasqyruar edhe qëndrimi i ankuesit, i cili ka deklaruar se nuk është dakort me largimin.

Ish mësuesi E.N asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk i është bërë presion, trajtim i pafavorshëm, presion apo diskriminim për shkak të gjendjes arsimore të tij nga drejtoria e institucionit arsimor dhe ZVA Klos, duke nisur nga fakti se: 1. Lista e organikave faktike për vitin shkollor 2019-2020, rezulton të jetë e njëjtë me të vitit të kaluar shkollor në lidhje me statusin e mësuesve, ku dhe ankuesi rezulton i emëruar ashtu si dy kolegët e tij në këtë shkollë; 2. Procedurat për kalimin e mësuesit nga me emërim në me kontratë i ankuesit janë bërë në të njëjtën mënyrë dhe formë, në të njëjtën datë dhe afat si dy kolegët e tij në këtë shkollë; 3. Për vendet e punës së këtyre tre mësuesve që kanë nivelin më të lartë të shkollimit të tyre bachelor, pati kërke nga mësues të tjerë në përputhje me udhëzimin nr.13, datë 22.05.2019 të MARS “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në IAP” dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Për vendin e punës në profilin e gjuhës së huaj frënge, me datë 17.10.2019, në emailin e shkollës vjen një email nga juristja e DRAP Durrës (ora 2:19 PM), ku mes të tjerash bën me dije kërkesën/ankesën e dy mësuesve L.L dhe A.LI për këtë vend pune; 4. Rezultoi se vetëm vendi i shpallur vakant për mësues të gjuhës frënge u zëvendësua nga një mësues i ardhur nga portali “Mësues për Shqipërinë 2019”, ndërsa dy vendet e tjera vakante për mësues të edukimit fizik dhe të AF që kishin dy mësuesit e tjerë me kontratë, nuk patën aplikantë nga portali apo që ishin në përputhje me kriteret e udhëzimit nr.13/2019. Më datë 09.01.2020 ZVA Klos mban një procesverbal për pranimin e vendit vakant në profilin gjuhë e huaj frënge në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, me nr.8 prot., nga kandidatja pjesmarrëse në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Një kopje e këtij procesverbali i’u dërgua shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos. Bazuar në këtë procesverbal, drejtoria e shkollës lidhi kontratën individuale të punës pa afat me nr. 52, datë 10.01.2020 me A.LI, në pozicionin mësuese e lëndës së gjuhës së huaj frënge; 5. Për pasojë vetëm mësuesi me nr.rendor 22, E.N, rezultoi i larguar nga puna, pasi vendi vakant ju ofrua kandidates së ardhur nga portali, ndërsa mësuesi me nr.rendor 20 A.L dhe mësuesi me nr.rendor 23 E.Sh, duke mos patur kandidatë nga portali, i’u bë rilidhja e kontratës individuale të punës me afat

të përcaktuar dhe vijojnë të punojnë me këtë status deri në paraqitjen e kandidatëve fitues nga Portali “Mësues për Shqipërinë”; 6. Që ndaj ankuesit nuk është ushtruar presion provohet edhe nga fakti se në drejtorinë e shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos apo në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes, apo në Komisionin e Ankimimit pranë kësaj shkolle nuk është protokolluar asnjë ankimim me shkrim të bërë nga ish mësuesi E.N.

Në gjykimin tonë, nuk ka mësues të tjerë që nuk plotësojnë kriterin e punësimit, pa procedura të motivuara. Asnjë nga mësuesit M.M, I.B, O.P, D.H dhe E.M, të cilët përmenden nga ankuesi, nuk rezultojnë të punësuar në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi, bazuar në dokumentat e dorëzuara.

- Bazuar në urdhrin nr. 42, datë 11.03.2020, Komisioneri vendosi pezullimin dhe shyrjen e seancave dëgjimore, për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19. Pezullimi për zhvillimin e seancave dëgjimore u ndërpre bazuar në urdhrin nr. 62, datë 01.06.2020, të Komisioneri, duke mundësuar kështu rifillimin e seancave dëgjimore.
- Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁸ dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 18.06.2020, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike. Seanca u zhvillua me pjesmarrjen e ankuesit dhe Zyrës Vendore Arsimore Klos, përfaqësuar nga juristi E.B, i pajisur me autorizimin nr.207 prot., datë 16.06.2020. Në seancë nuk u paraqit Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos, e cila edhe pse kishte rregullisht dijeni për datën e seancës nuk u paraqit dhe nuk paraqiti asnjë shkak për mosparaqitjen e saj. Gjatë seancës dëgjimore ankuesi shtoi në kërkimet e tij si shkak tjetër diskriminues bindjet politike duke pretenduar se ishte penguar dy herë në 2018 dhe 2019 nga T.K (aktualisht Drejtuese e ZVA Klos) nga e drejta për t’u përfshirë në provimin për marrjen e shkallës së parë të kualifikimit.
- Me shkresën nr.243 prot., datë 02.07.2020⁹, Zyra Vendore Arsimore Klos ka dërguar informacion shtesë, në vijim të pretendimeve të ngritura nga ankuesi gjatë seancës dëgjimore, duke prapësuar se:

T.K, Drejtuese e ZVA Klos nuk ka qenë personi përgjegjës për procedurat për dhënien e shkallës së kualifikimit për mësuesit e gjuhës së huaj, gjatë kohës që ka punuar si specialiste e sektorit të kualifikimit, e për rrjedhojë nuk është përgjegjëse për këtë çështje. Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike, ajo prapëson se një pretendim i tillë është i pavërtetë pasi nga viti 2017 Partia Demokratike është gjithashtu në opozitë dhe në vitin 2019 e cila përkon me kohën për të cilën ankohet z. E.N, PD dhe LSI kanë qenë në koalicion. Gjatë gjithë karrierës nuk i kam trajtuar kurrë njerëzit në bazë të bindjeve politike, pasi kjo është diçka që i përket jetës private të individëve. Për sa i përke aspektit njerëzor edhe unë do të isha në favor të qëndrimit të tij në punë për shkak të karrierës së tij 22 vjeçare si mësues, por institucionet funksionojnë mbi baza ligjore të cilat janë pengesë për ankuesin që të vazhdojë punën si mësues deri në përmbushjen e kritereve të nevojshme. Nëse do të kishim prirje për të ndëshkuar ankuesin për shkak të bindjeve të

⁸ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

⁹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.896 prot., datë 03.07.2020.

tij politike, do ta kishim bërë përpara se dy mësueset L.L dhe A.Ll të ankoreshin në Platformën e Bashkëqeverisjes.

Përsëri ne i kemi ofruar ankuesit një vend tjetër pune, të cilin ankuesi e ka refuzuar. Ky vend është krijuar për shkak të mungesës së mësuesit me arsim përkatës. Këto dy pozicione janë shpallur vakante dhe të drejtën e zgjedhjes e ka patur A.Ll si kandidate e ofruar nga portali “Mësues për Shqipërinë” dhe jo për të diskriminuar nxënësit e fshatit në barazinë për arsim cilësor.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune si mësues i gjuhës frënge në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos. Ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune në datën 01.09.2014 dhe ka një kontratë pune me afat të pacaktuar. Sipas librezës së punës, rezulton se ankuesi ka një eksperiencë prej 22 vitesh në sistemin arsimor, eksperiencë kjo e pranuar edhe nga ZVA Klos dhe Shkolla “Tahir Hoxha”, Klos. Në lidhje me nivelin arsimor të ankuesit, rezulton se ai ka përfunduar Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, në Tiranë në vitin 1984, zotëron Diplomë Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Freng, lëshuar nga Universiteti i Tiranës në vitin 2011 dhe ka fituar shkallën e 3-të të kualifikimit si mësues i gjuhës frënge, në vitin 1998 dhe shkallën e 2-të të kualifikimit si mësues i gjuhës frënge në vitin 2004. Sipas vërtetimit datë 15.11.2019, lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, i cili ndodhet në dosjen personale të ankuesit të vënë në dispozicion nga ZVA Klos, rezulton se ankuesi është student në vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, Programi i Studimit “Master i Shkencave” në “Mësuesi e gjuhës frënge në arsimin e mesëm të lartë”, për vitin akademik 2019-2020”.

Marrëdhëniet e punës në rastin e ankuesit rregullohen nga Kodi i Punës dhe nga ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁰.

Rezulton se në bazë të pikës 2, të vendimit nr.5, datë 30.09.2019 “Për miratimin e organikës dhe listës emërore të mësuesve”, ZVA Klos ka vendosur të refuzojë miratimin e listës emërore të mësuesve të shkollës Tahir Hoxha, Klos, për shkak të mospërputhjes së sistemit të arsimit të mësuesve me nr.rendor 20,22, 23, për të qenë të emëruar në vendet e punës dhe bie ndesh me ligjin nr. 69/2012 si dhe urdhrin nr.363, datë 16.09.2014. ZVA në pikën 3, të këtij vendimi kërkon nga Drejtoria e Shkollës marrjen e masave për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas kërkesave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Punës. Referuar listës emërore që i bashkëlidhet këtij vendimi rezulton se nr.rendor 20 i korrespondon A.L, mësues i edukimit fizik, nr.rendor 22 i korrespondon ankuesit dhe nr. rendor 23, i korrespondon E.Sh, mësuese e ciklit të ulët.

¹⁰ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Ligji nr.69/2012, i ndryshuar.

Bazuar në vendimin e mësipërm të ZVA Klos, me urdhrin e brendshëm nr.24 prot., datë 07.10.2019, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos ka ka urdhëruar që mësuesit me nr.rendor 20,22,23 (përfshirë ankuesin nr.rendor 22) brenda të njëjtës ditë duhet të nënshkruanin kontratat e punës me afat të caktuar dhe në rast refuzimi vendi i punës që gëzon punonjësi mësimor shpallet vakant dhe i nënshtrohet procedurave për lëvizje paralele sipas udhëzimit nr.13, datë 22.5.2019 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të MARS. Për njohjen me këtë urdhër nga ana e punonjësve të mësipërm, shkolla ka paraqitur procesverbalin datë 07.1.2019 sipas të cilit pretendohet se i është komunikuar ankuesit dhe mësuesve të tjerë urdhri nr 24/07.10.2019 dhe procesverbali datë 09.10.2019, sipas të cilit u komunikohet ankuesit dhe mësuesve të tjerë se në rast të mosnënshkrimit të kontratave me afat vendi i tyre i punës do të shpallej vakant. Të dy procesverbalet nuk mbajnë nënshkrimet e punonjësve por vetëm të mbajtësit të protokollit E.M, N/drejtoreshë e shkollës. Në procesverbal pasqyrohet se mësuesit kanë refuzuar të nënshkruajnë kontratat. Kontrata e punës me afat të përcaktuar që i është ofruar ankuesit është për një afat 3 muor, duke filluar nga data 07.10.2019 deri në datë 07.01.2020.*

Sa më sipër rezulton se Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” i ka propozuar ankuesit lidhjen e një kontrate me afat të përcaktuar 3 muor, ndërkohë që ai ishte personel mësimor i kësaj shkolle në marrëdhënie pune me afat të papërcaktuar. Duke i propozuar lidhjen e kësaj kontrate me afat të caktuar, punëdhënësi në një farë mënyre i komunikon punëmarrësit qëllimin për ndërprerjen e marrëdhënies ekzistuese të punës. Një procedurë e tillë nuk ka asnjë mbështetje ligjore në dispozitat e Kodit të Punës.

Sipas shkresës nr.28 prot., datë 09.10.2019, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, ka njoftuar ankuesin për t’u paraqitur në takim në datën 11.10.2019 për të biseduar në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës. Nuk provohet se kur i është komunikuar ankuesit ky njoftim. Bazuar në nenin 144/1 të Kodit të Punës parashikohet : *“1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të.”* Sa më sipër, edhe nëse marrim të mirëqënë se njoftimi i është komunikuar ankuesit në datën 9.10.2019 dhe takimi është lënë në datën 11.10.2019, rezulton se nuk është respektuar detyrimi ligjor që njoftimi për takimin duhet të realizohet të paktën 72 orë para takimi. Në datën 11.10.2020, rezulton të jetë realizuar takimi midis ankuesit dhe Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, fakt ky që pasqyrohet në procesverbalin me nr.30 prot, datë 11.10.2020. Nga përmbajtja e këtij procesverbali punëdhënësi deklaron se shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është mospërputhja e formimit universitar me profilin e vendit të punës, duke njoftuar ankuesin se zgjidhja e kontratës së punës do të bëhej në datë 07.1.2020. Nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se ankuesi ka marrë pjesë në takim dhe ka shënuar në procesverbal se nuk është dakort.

Bazuar në nenin 144/2/3 të Kodit të Punës parashikohet se : *“Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur. 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas*

takimit.” Sipas këtij parashikimi ligjor, takimi midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, bëhet me qëllim që ky i fundit t’i parashtrojë punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë. Sa më sipër rezulton se në takimin e datës 11.10.2019, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos e kishte marrë paraprakisht vendimin e zgjidhjes së kontratës së punës, pasi i ka komunikuar ankuesit se në datën 07.01.2020 do të bëhej ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Ndërkohë që sipas nenit 144/3 të Kodit të Punës, zgjidhja e kontratës së punës duhet të ishte njoftuar pas këtij takimi dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë dispozitë, pra brenda 48 orëve deri në 1 javë pas takimit. Me vendimin nr.13, datë 06.01.2020, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos ka vendosur lirimin nga detyra të ankuesit, duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës një ditë pas dhënies së këtij vendimi. Në pikën 2, të këtij vendimi përcaktohet se punëmarrësit duhet t’i paguhet afati i njoftimit dhe ditët që i takojnë për pushimet vjetore.

Duke u bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos nuk ka respektuar procedurën e parashikuar nga neni 144, i Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës.

ZVA Klos dhe Shkolla Tahir Hoxha kanë mbajtur qëndrimin se largimi nga puna i ankuesit është bërë për shkak se ai nuk përmbush kriteret e parashikuar nga neni 57, i Ligjit nr. 69/2012 dhe urdhrit nr.363/2014 *“Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar”*¹¹, të MARS. Neni 57, i ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar parashikon *“1.Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor. 2. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” dhe diplomë të ciklit të dytë “Master Profesional”, që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish - instituteve të larta pedagogjike. 3. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë. 4. Profesionin e mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuara në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Diplomë të ngjashme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzim të ministrit. 5. Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi: a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç*

¹¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën urdhri nr. 363/2014.

parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në pikën 3, të urdhrit nr. 363/2014 të MARS, i cili në fakt nuk parashikon kriteret por bën vetëm referencë në parashikimet e nenëve 57 dhe 72, të ligjit nr. 69/2012, parashikohet se: *“Mësues pa arsim përkatës të konsiderohen të gjithë ata mësues që nuk plotësojnë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në nenet 57 dhe 72, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.”*

Në nenin 72, pika 5 , i cili është pozicionuar në dispozitat kalimtare të ligjit nr.69/2012, parashikohet: *“5. Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe ka formimin përkatës universitar, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin. Ky përcaktim vlen edhe për mësuesit që kanë përfunduar arsimin e lartë pedagogjik 3-vjeçar, përpara hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës. Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin.*

Nga përmbajtja e këtij neni rezulton qartë se qëllimi i legjislatorin në miratimin e këtij neni ka qenë që të shmang vendosjen në pozita diskriminuese një numër të madh të personelit mësimor që prej vitesh janë të punësuar në sistemin arsimor dhe kanë fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesit në një kontekst dhe rregullim ligjor të ndryshëm nga rregullimet e vendosura nga ky ligj. Ndoshta në një të ardhme sistemi arsimor dhe kriteret për të fituar të drejtën për të qenë mësues apo emërtimet e diplomave të vlefshme për këtë qëllim mund të ndryshojnë, siç edhe rezulton të ketë ndodhur ndër vite, por eksperiencia në sistemin arsimor që personeli mësimor fiton ndër vite nuk mund të mos merret në konsideratë, pasi pavarësisht se legjislacioni pëson ndryshime dhe evoluon, sistemi arsimor nuk fillon në momentin e miratimit të këtyre ndryshimeve por ka tashmë një bazë të konsoliduar, duke përfshirë këtu personelin arsimor që ka ushtruar mësimdhënien për shumë breza. Brezat e rinj të cilët diplomohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi me shumë gjasa janë produkt i punës së këtyre arsimtarëve.

Bazuar në këtë nen personeli mësimdhënës, që në kohën e miratimit të ligjit ka qenë i punësuar me kontratë të përhershme dhe ka patur formimin përkatës universitar, pa bërë ndonjë përcaktim në lidhje me nivelin e diplomës universitare, ruan vendet e punës. Mundësia për të ruajtur vendet e punës i është dhënë edhe personelit mësimor që ka qenë i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit.

Sa më sipër parashikimet e nenit 57, të ligjit nr. 69/2012 nuk mund të zbatohen të pavarura nga parashikimet e nenit 72, të po këtij ligji. Kjo do të thotë që kategoritë e mësipërme janë konsideruar nga ligji që përmbushin kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit. Kjo kategori nuk mund të

konsiderohet si personel mësimor i cili do të hyjë rishtazi në sistemin arsimor pas këtyre ndryshimeve ligjore. Pra, ligji kërkon që i gjithë personeli mësimor i cili do të punësohej rishtazi nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit e në vijim të plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 57, por ndërkohë ka vlerësuar si të përmbushura këto kriteret nga kategoritë e mësipërme.

Referuar librezës së punës rezulton se ankuesi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 69/2012 ka qenë i emëruar si mësues në Shkollën Patin nga 01.11.2011 deri në 31.08.2014 dhe më pas është transferuar mësues në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Ankuesi në kohën e miratimit të ligjit nr.69/2012 ishte pajisur me diplomë universitare në Degën Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Frëng, të cilën e ka përfituar në vitin 2011, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos në prapësimet e saj shprehet se ankuesi mund të ruante vendin e punës vetëm nëse kishte fituar shkallën e tri shkallët e kualifikimit. Por një gjë e tillë, kërkohet për kategorinë e personelit mësimor të parashikuar nga pika 5, e nenit 72, që kanë përfunduar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi. Ankuesi ka përfunduar Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi” në Tiranë dhe ka fituar kategorinë e 2-të të kualifikimit. Në kohën e miratimit të këtij ligji ankuesi zotëronte edhe diplomë universitare në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Frëng dhe ka qenë i punësuar në një nga nivelet e arsimit parauniversitar dhe si i tillë ai nuk mund të vlerësohet për kriteret e vendosura nga neni 57, i ligjit nr. 69/2012 në mënyrë të pavarur nga parashikimet e nenit 75/5 të këtij ligji. Kategoritë e personelit mësimor të parashikuar nga neni 72/5 të ligjit nr. 69/2, ruajnë vendet e punës pa patur nevojë që të plotësojnë më tej nivelin e diplomës që zotërojnë, t’ju kërkohet praktikë profesionale apo kalimi i provimit të shtetit.

Edhe urdhri nr.363/2014, i MARS, e lidh zbatimin e nenit 57 me nenit 72, të ligjit nr. 69/2012. Më tej në pikën 7 të tij, urdhri parashikon : *“Për zbatimin e këtij urdhri, DAR/ZVA të raportojnë te Sekretari i Përgjithshëm në MAS, brenda datës 26.09.2014.”* Pra, ky është një urdhër me një kohë veprimi të caktuar, deri në datën 26.09.2014. Rezulton se ankuesi në datën 01.09.2014 është emëruar mësues i gjuhës frënge, në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Sipas ankuesit ai u sistemua si mësues i gjuhës së huaj frënge në shkollën 9-Vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, si pasojë e miratimit në atë kohë të urdhrit nr.363/2014 të MARS sipas të cilit mësuesit duhet të sistemoheshin në profilin e lëndës që zotëronin diplomën. Ankuesi ishte në kohën e miratimit të ligjit nr.69/2012, personel mësimor me emërim dhe jo me kontratë me afat të përcaktuar dhe zotëronte Diplomë Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Frëng.

Në nenin 60/2, të ligjit nr.69/2012, parashikohet: *“.....Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, rezultatet në provimet kombëtare dhe institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. ...”* Referuar nenit 144/3, të Kodit të Punës, arsyet për të cilat një punëdhënës mund të zgjidhjë kontratën e punës duhet të jenë të lidhura me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale

të ndërmarrjes. Nuk rezulton që zgjidhja e kontratës së punës në rastin e ankuesit të jetë bërë për një nga rastet e parashikuara nga dispozita e mësipërme.

Komisioneri vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës me afat të pacaktuar për mësuesin në arsimin parashkollor për shkak të mos përputhjes së formimit universitar, në rastin konkret niveli i diplomës dhe jo profili i saj, nuk përbën një shkak të parashikuar nga ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, për largimin e mësuesit nga institucioni arsimor, sipas nenit 60 të këtij ligji dhe Kodi i Punës. Komisioneri vlerëson gjithashtu se zgjidhja e marrëdhënieve të punës për shkak të mospasjes së një diplome të ciklit të dytë të studimeve universitare, në kushtet kur ankuesi ka 22 vite eksperiencë punë në arsim është jo vetëm e paligjshëm por edhe i palogjikshme.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se ishte penguar nga T.K, aktualisht drejtuese e ZVA Klos, nga e drejta për t’u përfshirë në provimin për marrjen e shkallës së parë të kualifikimit, nuk u paraqitën prova të mjaftueshme për të provuar se ankuesi ka aplikuar dhe periudhën kur ka aplikuar.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin për shkak të mospërputhjes së formimit universitar me profilin e vendit të punës (niveli i diplomës universitare dhe jo profili) vjen në kundërshtim me parashikimet e mësipërme të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodin e Punës. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm.

B. Shkak i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹², i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkak të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bindjet politike dhe gjendja arsimore, konsiderohen si shkaqe të

¹² Shih më lart *footnote* nr. 4.

mbrojtura nga ligji. Po ashtu, Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9¹³ të tij parashikon “*bindjet politike*” dhe “*gjendjen arsimore*”, si shkaqe për të cilat ofrohet mbrojtje në gëzimin e të drejtës për punësim dhe profesion.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” duke shpjeguar se i është nënshtruar një trajtimi diferencues dhe më pak të favorshëm gjatë ushtrimit të së drejtës për punësim dhe ushtrimit të profesionit të mësuesit të zgjedhur lirisht prej tij (profesion në të cilin ka një përvojë 22 vjeçare) për shkak të nivelit të diplomës universitare. Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi se ankuesi është larguar nga puna me motivacionin se formimi i tij universitar nuk përputhet me vendin e tij të punës, pasi ai nuk zotëron diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare (diplomë master), kusht ky që kërkohet për të ushtruar profesionin e mësuesit në arsimin e mesëm të ulët, pozicion i mbajtur nga ankuesi si mësues i gjuhës frënge, në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.

Për këto arsye, Komisioneri vlerëson se diferenca në trajtim që bazohet në nivelin e arsimit të një personi, do të konsiderohet si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore dhe sa më sipër rezulton se ankuesi ka të vërtetuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes arsimore.

Ankuesi pretendon gjithashtu se është diskriminuar edhe për shkak të bindjeve politike, nga ana e T.K, Drejtuese e ZVA Klos. Ankuesi deklaron se ai ka qenë numëruar në zgjedhje për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe se bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të drejtueses së ZVA Klos, e cila sipas ankuesit është me Partinë Demokratike. Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesi ka depozituar vërtetimin me nr.1260/1 prot., datë 07.07.2020, lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas të cilit rezulton se ankuesi, i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017, ka ushtruar detyrën e anëtarit të Grupit të Numërimit të Votave KZAZ nr.17, Qarku Dibër. Në këtë mënyrë ankuesi provon pretendimin për bindjet e tij politike.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

¹³ Neni 9/2, i Kodit të Punës, parashikon: “Me “*diskriminim*” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike**, **arsimore** ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*¹⁴, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹⁵. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*¹⁶ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi, bazuar në një listë të hapur shkaqesh¹⁷.

*Karta Sociale Europiane*¹⁸ parashikon të drejtën për punë (neni 1) si dhe të drejtën për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimit (neni 24). Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “*Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër*”.

Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe

¹⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁵ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁷ Sipas përcaktimeve të Konventës termi diskriminim përfshin: - çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen ndërkombëtare, ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit; - çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, nëse këto ekzistojnë, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

¹⁸ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹⁹

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në nenin 9/1 të Kodit të Punës parashikohet: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndërsa në nenin 9/2 të Kodit të Punës, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim që bazohet në një nga shkaqet e mbrojtura ndër të tjera edhe në bindjet politike, që ka si qëllim apo pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²⁰ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të

¹⁹ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

²⁰ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.²¹

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm. Ankuesi ka pretenduar se sjellja diskriminuese ndaj tij ka si shkak gjendjen e tij arsimore të marrë së bashku me bindjet e tij politike. Komisioneri vlerëson se ankuesi provoi bindjet e tij politike, por jo faktin se ekziston një lidhje shkakësore midis trajtimit të padrejtë dhe bindjeve politike të ankuesit. Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike është i pabazuar.

²¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ankuesi ka pretenduar se ai është trajtuar në mënyrë të pafavorshme duke i'u zgjidhur kontrata e punës për shkak se nuk zotëron diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare dhe se mësues të tjerë në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos dhe në institucione të tjera arsimore të ZVA Klos janë mbajtur në punë me një kualifikim më të ulët se ai. Bazuar në dokumentacionin e administruar lidhur me këta punonjës, rezultoi se:

- A.L me nr.rendor 20, mësues i edukimit fizik, ka qenë i emëruar si mësues në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Sipas librezës së punës dhe dosjes personale, ky mësues ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos që prej muajit shtator 2002 deri në datë 06.01.2020, kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Ai zotëron diplomë si mësues në degën cikël i ulët, fituar në 1996 dhe diplomë bachelor në degën e edukimit fizik, të fituar në vitin 2015. Rezulton se mësuesit A.L, sikundër ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak mospërputhjes së nivelit të diplomës me vendin e punës. Mësuesi A.L ka vazhduar marrëdhëniet e punës në këtë shkollë bazuar në kontratë me afat të përcaktuar, duke i'u ndryshuar statusi nga mësues me emërim në mësues me kontratë. Sipas listës emërore me nr.17 prot., datë 25.09.2019 që i bashkëlidhet vendimit nr.5, datë 30.09.2019 të ZVA Klos, mësuesi ka 22 vite eksperiencë në arsim. Ka fituar shkallën e II-të të kualifikimit si mësues i edukimit fizik, në vitin 2009.
- E.Sh me nr.rendor 23, mësuese e ciklit të ulët, ka qenë e emëruar si mësuese në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Sipas librezës së punës dhe dosjes personale rezulton se ajo ka qenë mësuese në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos që prej muajit shtator 2008 deri në datën 06.01.2020 kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Ajo zotëron diplomë DNP, Dega Cikël i ulët (arsim fillor), fituar në 2005. Rezulton se mësuesja E.Sh, sikundër ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak mospërputhjes së diplomës me vendin e punës. Mësuesja E.Sh ka vazhduar marrëdhëniet e punës në këtë shkollë bazuar në kontratë me afat të përcaktuar, duke i'u ndryshuar statusi nga mësuese me emërim në mësuese me kontratë. Ajo ka 11 vite eksperiencë në arsim dhe ka fituar shkallën e II-të të kualifikimit në cilëk i ulët, në vitin 2014.
- M.M, është mësuese e emëruar në Shkollën 9-vjeçare Tahir Hoxha, Klos. Rezulton se ka mbaruar Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Shejnaze Juka”, dega anglisht, në vitin 2002. Ajo është diplomuar “Mësuese e gjuhës shqipe dhe letërsisë”, në vitin 2012. Në 2015 ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare dhe është pajisur me Diplomë Master i Shkencave në Mësimdhënie “Gjuhë Letërsi Anglisht”. Në vitin 2014 në provimin e Shtetit është licënsuar për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin “Gjuhë shqipe dhe letërsi”. Mësuesja ka 17 vite eksperiencë në arsim. Ka fituar kategorinë e 3-të të kualifikimit si mësuese e gjuhës angleze në vitin 2009 dhe kategorinë e 2-të të kualifikimit si mësuese e gjuhës angleze në vitin 2015. Sipas ankuesit kjo mësuese vazhdon të punojë edhe pse nuk ka fituar të 3 shkallët e kualifikimit dhe është jashtë profilit pasi arsimin e lartë e ka kryer për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi dhe aktualisht jep mësim për gjuhën angleze.
- I.B, mësues në profilin muzikë, është mësues me kontratë në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. I.B ka përfunduar Akademinë e Arteve, specialiteti Kontrabas, në vitin 2011. Sipas ankuesit ky mësues vazhdon mësimdhënien edhe pse nuk ka diplomë mësuesie. ZVA Klos dhe

Shkolla Tahir Hoxha, Klos prapësuan se ky mësues për nevoja të shkollës lidh në mënyrë të vazhdueshme kontrata me afat me institucionin arsimor pasi nuk ka mësues në lëndën e muzikës nga Portali Mësues për Shqipërinë.

- O.P, është prej 2 vitesh zëvendës/drejtoresh me komandim në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Ajo ka mbaruar studimet bachelor në degën Gjuhë shqipe dhe Letërsi, në vitin 2009, dhe është e pajisur me diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave në Letërsi, fituar në vitin 2011. O.P është licencuar për të ushtruar profesionin e mësuesit në profilin Letërsi, studime letrare shqipe e antropologji kulturore, në vitin 2013. Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” ka deklaruar se ajo është punësuar me emërim në vitin 2015, nëpërmjet Portalit Mësues për Shqipërinë. Sipas ankuesit ajo nuk plotëson kriteret e udhëzimit nr.58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, kreu II, pika 1, gërma a dhe b. Ajo nuk ka të paktën kategorinë mësues i kualifikuar dhe licenca i është dhënë jo në përputhje me ligjin sepse nuk ka diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit. Shkolla Tahir Hoxha në shpjegimet që jep në lidhje me këtë mësuese, shprehet se ajo është emëruar me komandim, pasi nuk zotëron kategorinë mësues i kualifikuar, kriter ky i parashikuar në udhëzimin nr. 58/2013 në mënyrë që të emërohet. Por, në dallim nga niveli arsimor i ankuesit shkolla shprehet se punonjësja mësimore O.P ka kryer ciklin e dytë të studimeve master, është licencuar për ushtrimin e profesionit të mësuesit, ka hyrë në sistemin arsimor nëpërmjet Portalit Mësues për Shqipërinë.
- E.M, është mësuese e arsimit fillor dhe është emëruar si N/drejtoreshë në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Në lidhje me këtë mësuese ankuesi ngre pretendimin se ajo është emëruar pa u zhvilluar procedurat e konkurimit. Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit në lidhje me këtë punonjëse nuk ka lidhje me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe diferencës në trajtim për shkak të nivelit të diplomës universitare të zotëruar.
- D.H, është mësuese në profilin e arsimit fillor dhe jep mësim në Shkollën “Rexhep Shira”, Fullqe Klos. Ajo zotëron diplomë të nivelit të parë në ciklin e ulët, të fituar në vitin 2008. Ka fituar kategorinë e 3-të të kualifikimit në vitin 2014. Sipas ZVA Klos pretendimi i ankuesit se kjo mësuese nuk ka diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, është i pabazuar pasi sipas vërtetimit me nr.1863 prot datë 25.11.2019 ajo është studente e vitit të dytë akademik në degën Master në mësuesi për arsim fillor, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Kjo mësuese rezulton të jetë e punësuar me kontratë. Ankuesi ka pretenduar se kjo mësuese është e emëruar në mënyrë definitive, ndërsa sipas ZVA Klos ajo është e punësuar me kontratë me afat të caktuar. Në mbështetje të këtij pretendimi ZVA Klos ka depozituar kontratën e punës me afat të caktuar me nr.21/3 prot datë 06.01.2020 lidhur midis mësueses D.H dhe drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Rexhep Shira”, Fullqe. Kjo kontratë është lidhur për një periudhë nga 06.01.2020 deri në 31.03.2020. Referuar librezes së punës rezulton se, ajo ka filluar punë si mësuese në shkollën Fullqet në vitin 2008 ku ka punuar deri në maj 2019 kur është ristrukturuar Zyra Arsimore Mat, nga e cila varej kjo shkollë. Në librezë nuk është pasqyruar nëse marrëdhëniet e punës së kësaj ankuese me shkollën Fullqet kanë vazhduar pas ristrukturimit të bërë në maj 2019 dhe gjithashtu nuk është pasqyruar marrëdhënia e punës së vendosur me kontratën individuale të punës të nënshkruar për një afat 3 mujor në datën 06.01.2020.

Siç shihet në rastin e mësueses M.M, e cila punon si mësuese e gjuhës angleze, ajo ka diplomë bachelor në gjuhë letërsi dhe master shkencor me profil në gjuhën angleze. Në ditët e sotme diplomat universitare janë të orientuara drejt një qasje jo të ngurtë dhe fleksible për t'i lejuar individëve një përshtatje më të madhe me kërkesat e tregut të punës. Ajo punon si mësuese e gjuhës angleze, por licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit e ka për mësuese në profilin “Gjuhë shqipe dhe letërsi”. Mësuesja M.M ka një eksperiencë të konsiderueshme në arsim pre 17 vitesh dhe nga rrethanart dhe faktet e parashtruara më sipër ajo ka qenë e punësuar në sistemin arsimor në kohën e miratimit të ligjit nr.69/2012, i ndryshuar dhe ka patur një diplomë bachelor në gjuhë letërsi të fituar në 2012 edhe pse rezulton që të ketë punuar gjithmonë si mësuese e gjuhës angleze. Ajo e zotëron licencën për profilin gjuhë shqipe dhe letërsi dhe jo mësuese e gjuhës angleze. Në vlerësimin llojit/profilin të diplomës universitare dhe plotësimit të kriterëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit, ZVA Klos dhe Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” kanë treguar fleksibilitet dhe i kanë dhënë rëndësi eksperiencës së kësaj mësueseje dhe me të drejtë, por ato kanë dështuar që këtë qasje t’a zbatojnë edhe në rastin e ankuesit, por edhe të dy mësuesve të tjerë A.L dhe E.SH.

Në rastin e mësueses D.H, ZVA Klos konsideron se kjo mësuese përmbush kriterin e diplomës universitare të ciklit të dytë pasi ajo vazhdon studimet në Degën “Master në mësuesi për arsimin fillor”. Nga dosja personale e ankuesit e venë në dispozicion nga ZVA Klos rezulton se edhe ankuesi ka të depozituar pranë ZVA Klos një vërtetim të ngjashëm me këtë mësuese, ku ai figuron i regjistruar si student në ciklin e dytë të studimeve në programin e studimit Master i shkencave në Mësuesi e Gjuhës Frënge për arsimin e mesëm të lartë, pranë Universitetit të Tiranë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Sa më sipër përforcon bindjen e Komisionerit se, mësuesit për shkak të mosmarrjes në konsideratë të dispozitave kalimtare të ligjit nr.69/2012, konkretisht nenit 72, vendosen në kushte të pafavorshme duke ju kërkuar një nivel i caktuar i diplomës universitare apo marrja e licencës për ushtrimin e profesionit, deri në largimin nga puna si në rastin e ankuesit. Sipas nenit 57/5/a, të ligjit nr. 69/2012, për të ushtruar profesionin me mësuesit kërkohet edhe që mësuesi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale. Kjo kërkesë tregon qartë se në tërësi zbatimi i kriterëve të parashikuara nga neni 57, i ligjit nr. 69/2012 është për personat që hyjnë në sistem pas miratimit të këtyre parashikimeve dhe se detyrimisht neni 57, duhet të zbatohet i kushtëzuar nga neni 72, i ligjit.

Në thelb kufizimi të cilit i është nënshtruar ankuesi ka të bëjë me faktin se niveli i tij arsimor nuk duhet të shërbejë si shkak për trajtimin e tij në mënyrë më pak të favorshme. Rezulton se të dy mësuesit A.L dhe E.Sh, kanë qenë në marrëdhënie pune në Shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos në kohën e miratimit të ligjit 69/2012, i ndryshuar. Ata kanë një eksperiencë të gjatë në arsim si mësues në profilet përkatëse, A.L në profilin Edukim Fizik dhe E.Sh në profilin cikël i ulët. Të dy këta mësues kanë gjithashtu diplomat universitare në përputhje me profilet e tyre. Komisioneri vlerëson se të dy këta mësues nuk duhet të ishin larguar nga puna me justifikimin se nuk zotëronin nivelin e caktuar të diplomës universitare pasi në bazë të nenit 72, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar niveli universitar i zotëruar prej tyre në momentin e miratimit të këtij ligji është vlerësuar në

përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë rast ata janë trajtuar vërtetë në mënyrë të ngjashme me ankuesin, por sikundër ankuesi ata janë trajtuar në mënyrë të padrejtë duke u larguar nga puna për shkak të mungesës së nivelit të diplomës universitare.

A mund ta largosh një mësues i cili ka rreth 22 vite eksperiencë në arsim, me justifikimin se nuk ka përmbushur kriteret për ushtrimin e profesionit të mësuesit të parashikuar nga neni 57/5/a, pasi nuk ka kaluar me sukses praktikën profesionale, kërkesë kjo që sikundër kërkesa për pasjen e një diplome universitare të ciklit të dytë, përbën një nga kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit? Padyshim që do ishte në kundërshtim me logjikën më minimale të konsiderosh se një mësues i tillë duhet të kryejë praktikën profesionale. Arrijmë në të njëjtin përfundim edhe kur kërkojmë një nivel të caktuar diplome, për mësues të punësuar prej një kohe të gjatë në arsim, të cilët i kanë treguar aftësitë e tyre për të ushtruar profesionin e mësuesit. Personat e vendosur në kontekste të caktuara kohore i janë nënshtruar rregullimeve të caktuara për ushtrimin e profesionit. Ata nuk duhet të penalizohen apo të ndalohen për të ushtruar profesionin për shkak se nuk zotërojnë një nivel të caktuar të studimeve universitare. Për më tepër aftësitë dhe performanca e mësuesve është objekt i vlerësimeve periodike të punës së mësuesve.

Siç është theksuar edhe më sipër ligji nr. 69/2012 ka parashikuar dispozitën tranzitore nenin 72, për të shmangur efektet diskriminues për mësuesit të cilët janë bërë pjesë e sistemit përpara miratimit të kriterëve ligjore. Neni 57, i ligjit nr.69/2012 parashikon se profesioni i mësuesit ushtrohet edhe nga persona që zotërojnë diplomë universitare të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe njohuri të certifikuara në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, pra jo domosdoshmërisht diplomë në fushën e mësuesisë. Ndryshe nga parashikimet në udhëzimin nr.2, datë 12.02.2015 *“Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”*, sipas të cilit kandidatët për kualifikim duhet të kishin diplomë mësuesie, me miratimin e udhëzimit nr.8, datë 26.03.2020 *“Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”*, i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr.2/2015, rezulton se : *“Kandidatët për kualifikim, janë punonjësit e institucioneve arsimore publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë, apo diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimit fizik”*.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se vendi i punës i mbajtur prej ankuesit është plotësuar me mësuesen A.Ll. Kjo mësuese sipas deklarimeve të ZVA Klos dhe Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos në datën 30.09.2019 ka paraqitur ankesë në Portalin e Bashkëqeverisjes “Shqipëria që Duam” duke pretenduar se ka mësues të profilit gjuhë frënge pa arsimin përkatës. E njëjta ankesë është paraqitur edhe nga një mësuese tjetër (L.L) në datën 08.10.2019. Pas marrjes së ankesave ZVA Klos ka kërkuar interpretim juridik nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës). Ky institucion në përgjigjen e dërguar me email në datë 17.10.2019 ka sqaruar se: *“Në përgjigje të kërkesës/ankesës së mësueseve L.L dhe A.Ll, mësuese në shkollat në varësi të ZVA Klos ju sqarojmë si më poshtë vijin: Mësuesi i gjuhës frënge në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, E. N., nuk përmbush kriteret ligjore për të ushtruar profesionin e*

mësuesit (ligji 69/2012, neni 57 “Profesioni i mësuesit”) në këto kushte në bazë të ligjit nr. 7961 “Kodi i Punës” Drejtori i institucionit arsimor do fillojnë procedurat e largimit nga detyra. Për dy mësueset e sipërcituara që preetendojnë të njëjtin vend pune në shkollën Tahir Hoxha, Klos do të zbatohet udhëzimi nr.13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimiit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

ZVA Klos ka kërkuar konsulencën juridike nga DRAP Durrës, por rezulton se ajo e kishte marrë vendimin nr.5, datë 30.09.2019 për mos miratimin e listës organike të shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos në lidhje me ankuesin. Gjithashtu rezulton se Shkolla “Tahir Hoxha”, Klos në zbatim të vendimit të ZVA Klos kishte filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin përpara marrjes së përgjigjes nga ana e DRAP Durrës. Pra të dy këto subjekte kishin ndërmarrë veprime konkrete për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së ankuesit përpara se të kërkonin konsulencën juridike nga DRAP Durrës. Duhet thënë se konsulenca nga DRAP Durrës nuk është detyruese, pasi vendimarrja për zgjidhjen e kontratës së punës nuk i takon DRAP Durrës, por drejtorit të institucionit arsimor. Por konsulenca nga DRAP Durrës paraqitet nga subjektet si justifikim për vendimarrjen e tyre edhe pse këto subjekte i kishin marrë vendimet në lidhje me ankuesin para se të merrnin konsulencën. DRAP Durrës ka rekomanduar që për dy mësueset që kishin paraqitur ankese për vendin e punës të mbajtur nga ankuesi duhet të zbatohet udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimiit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Nga përmbajtja e emailit të mësipërm rezulton se të dy mësueset që kanë bërë ankesë janë mësuese në shkollat në varësi të ZVAP Klos. Gjatë seancës dëgjimore ankuesi gjithashtu pretendoi se mësuesja A.Ll ishte mësuese në marrëdhënie pune në shkollën “Ramiz Kadiu”, Bejn, një shkollë kjo në periferi dhe e kanë transferuar në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, që është shkollë në qytet.

Bazuar në procesverbalin për pranimin e vendit vakant me nr.8, datë 09.01.2020 të ZVA Klos, rezulton se ZVA Klos i ka ofruar kandidatet A.Ll si pjesëmarrëse në Portalin “Mësues për Shqipërinë 2019”, profili Gjuhë frënge, vendin e lirë të punës pa afat në profilin Mësues i lëndës Gjuhë e Huaj Frëngjisht në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos. Sipas këtij procesverbali kandidatja është e para sipas renditjes në portal me 37 pikë. Kandidatja A.Ll ka pranuar këtë vend pune. Sipas të dhënave të Portalit që i janë bashkëlidhur procesverbalit rezulton se, A.Ll me kod identifikimi 8511, ka dërguar 3 aplikime në portal për 2019 dhe konkretisht në ZVA Mat, ZVA Klos dhe ZVA Tiranë, në profilin e vendit të punës gjuhë frënge. Bazuar në këtë procesverbal A.Ll rezulton si kandidate e Portalit e cila deri në ato momente nuk ishte e punësuar si mësuese. Ndërkohë sipas pretendimeve të ankuesit por edhe nga përgjigja e DRAP Durrës rezulton se A.Ll ka qenë mësuese në një nga shkollat në varësi të ZVA Klos.

Nga verifikimet e kryera nga Komisioneri në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar²², referuar Tabelës së Transparencës së Portalit “Mësues për Shqipërinë dhjetor 2019”, të publikuar nga DRAP Durrës mësuesja me kodin 8511 (që është kodi i A.Ll si

²² <http://arsimiparauniversitar.gov.al/>

pjesmarrëse në Portalin Mësues për Shqipërinë 2019), figuron e punësuar në shkollën “Ramiz Kadiu”, shkollë në varësi të ZVA Klos.²³

Lista e Transparencës për Portalin Mësues për Shqipërinë, është një detyrim në kuadër të parashikimeve që bëhen në udhëzimin 13/22.05.2019. Bazuar në pikën 9, Kreu I të udhëzimit, DRAP ka detyrimin të konfirmojë menjëherë në portal listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 ditëve të para të çdo muaji. Sipas pikës 14, të këtij kreu në rast refuzimi të kandidatit fitues, kandidati vazhdon të qëndrojë në rënditje dhe atij i ofrohen vende të tjera të lira, deri në procedurat e hapjes së Portalit të ri “Mësues për Shqipërinë”. Sa më sipër rezulton se mësuesja A.LI ka pranuar vendin e punës në shkollën “Ramiz Kadiu”, Bejn, pasi ajo është deklaruar e punësuar në tabelën e transparencës për portalin në muajin dhjetor 2019 dhe gjithashtu ajo referohet në korrespondencën e DRAP si mësuese në një nga shkollat në varësi të ZVA Klos. Pra, rezulton se A.LI si fituese nga Portali Mësues për Shqipërinë 2019 ka pranuar vendin e punës që i është ofruar dhe është punësuar pranë Shkollës Ramiz Kadiu, Bejn.

DRAP Durrës në konsulencën e dërguar shprehet se për dy mësueset që kanë paraqitur ankesë duhet të ndiqen procedurat e parashikuara nga udhëzimi nr. 13/22.05.2019. Sipas urdhrit të brendshëm nr. 24 prot, datë 07.10.2019 të miratuar nga drejtori i shkollës “Tahir Hoxha” Klos, se në rast refuzimi nga ana e ankuesit të kontratës me afat, vendi i tij i punës do të shpallej vakant dhe do t’i nënshtrohej procedurave për lëvizje paralele, sipas udhëzimit nr.13/2019.

Udhëzimi nr.13.2019, në pikën 7, kreu I, parashikon se vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve pa ngarkesë mësimore deri 1 ditë para fillimit të vitit mësimor. Sipas pikës 9, kreu I, DRAP përgjatë vitit mësimor konfirmon në portal vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor të varësisë, brenda 5 ditëve të para të çdo muaji. Në pikën 10 të po këtij kreu parashikohet se DRAP dhe institucionet e varësisë kanë detyrimin të bëjnë publike vendet e lira të punës në portalin Mësues për Shqipërinë, në faqen zyrtare të tyre dhe stendat e informimit publik. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që vendi i mbajtur nga ankuesi pas largimit të tij të jetë shpallur si vend i lirë pune sipas procedurave të parashikuara nga udhëzimi nr. 13/22.05.2019. Ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 07.01.2020 dhe në datën 09.01.2020 vendi i tij i punës i është ofruar A.LI, me të cilën Shkolla 9-vjeçare Tahir Hoxha ka lidhur kontratën e punës me afat të pacaktuar nr.52 prot., datë 10.01.2020, pa respektuar procedurat e transparencës të parashikuara nga dispozitat e mësipërme të udhëzimit nr. 13/22.05.2019. Rezulton gjithashtu se në rastin e punësimit të mësueses A.LI në vendin e punës të mbajtur më parë nga ankuesi, janë zbatuar procedurat për lëvizjen paralele të parashikuara në kreun 7, të këtij udhëzimi, siç ka, pasqyruar në urdhrin e brendshëm nr. 24, datë 07.10.2019, drejtori i shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.

Në shpjegimet e dhëna nga ZVA Klos ajo shprehet se i ka ofruar ankuesit vend pune me kontratë me afat si mësues në Shkollën “Ramiz Kadiu” Bejn, por ai e ka refuzuar. Ankuesi nuk e refuzon

²³ Shiko: <http://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/DRAP-DURR%C3%8BS-TABELA-E-TRANSPARENC%C3%8BS-PORTALIT-M%C3%8BSUES-P%C3%8BR-SHQIP%C3%8BRIN%C3%8BDHJETOR-2019.pdf>

faktin që i është ofruar ky vend pune, por sqaron se ai nuk mund të pranonte një vend pune që përkeqësonte situatën e tij nga mësues me kontratë me afat të pacaktuar dhe në mësues me kontratë me afat. Nga e gjithë kronologjia e fakteve të mësipërme del qartë se vendi vakant që i është ofruar ankuesit është vendi i mbajtur nga mësuese A.Ll e cila është punësuar sipas procedurave të mësipërme në vendin e punës që më parë i përkiste ankuesit.

Një person i plotëson kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit ose nuk i plotëson ato. Qasja e ZVA Klos duke i propozuar ankuesit një vend pune në një shkollë tjetër periferike siç është shkolla “Ramiz Kadiu” Bejn, por jo t’u lejojë atë që të vazhdojë punën si mësues në shkollën “Tahir Hoxha”, Klos e cila rezulton të jetë shkollë në qytet, me pretendimin se nuk përmbush kriteret për të qenë mësues nuk është e drejtë. Një mësues i cili largohet nga puna se nuk plotëson kriteret për të qenë mësues, nga ana tjetër vlerësohet se mund të japë mësim në një shkollë periferike. Pra, ankuesi nuk plotëson kriteret për të qenë mësues në një shkollë në qytet, por mund të japë mësim në një shkollë periferike. Kjo qasje e ZVA Klos ngre dyshime mbi pretendime për diskriminim për shkak të vendbanimit, që potencialisht mund të pësojnë fëmijët që ndjekin arsimin në shkolla rurale. Edhe pse sa më sipër nuk është objekt i kësaj ankese, Komisioneri i shqetësuar vë në dukje një konstatim të tillë.

Rezulton se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm dhe se ky trajtim ka ardhur si rezultat i gjendjes së tij arsimore. Në këto kushte dhe bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon ZVA Klos dhe Shkollës 9-vjeçare Tahir Hoxha, Klos të tregojnë që kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet. Siç është theksuar edhe më sipër, një justifikim i tillë duhet të jetë objektiv dhe i arsyeshëm ose, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Prezantimi i kërkesave për nivele të caktuara të diplomave universitare dhe kalimi i mësuesve në procese verifikuese përtej marrjes së diplomës universitare, si pajisja me licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, synojnë të garantojnë një arsim cilësor për fëmijët. Qëllimi për të siguruar një arsim cilësor, padyshim që është një qëllim legjitim.

Megjithatë kur gjykohet në lidhje me ekzistencën e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, duhet gjithashtu të vlerësohet nëse ekziston një marrëdhënie të arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet. Sipas nenit 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- *I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.*
- *I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe*
- *Në përputhje me nevojën që e ka diktuar atë.*

Në vendimin nr.20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti

administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrë dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”

Duke u bazuar në gjithë arsyetimin e mësipërm Komisioneri arrin në përfundimin se kufizimi i vendosur mbi ankuesin për të ushtruar profesionin e mësuesit, nuk është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme dhe në përpjestim me nevojën që e ka diktuar atë. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se është cënuar parimi i proporcionalitetit pasi nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme midis qëllimit të ligjshëm të synuar dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Në këto kushte, ZVA Klos dhe Shkolla 9-vjeçare Tahir Hoxha, Klos nuk arritën të provojnë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin më pak të favorshëm që i është bërë ankuesit për shkak të gjendjes së tij arsimore dhe për rrjedhojë ankuesi është diskriminuar në të drejtën e tij për punësim dhe profesion për shkak të gjendjes arsimore.

Komisioneri vlerëson se ZVA Klos dhe Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, janë bashkarisht përgjegjëse për sjelljen diskriminuese, pasi me veprimet e tyre të drejtëpërdrejta kanë sjellë si pasojë trajtimin e ankuesit në mënyrë më pak të favorshme. Drejtori i Shkollës 9-vjeçare Tahir Hoxha, Klos është subjekti që është i autorizuar nga ligji për të lidhur dhe për të zgjidhur kontratën e punës me mësuesin, dhe në cilësinë e punëdhënësit ai është përgjegjës për sjelljen diskriminuese ndaj ankuesit. Por njëkohësisht rezulton se fillimi i procedurave nga ana e tij ka ardhur pas nxjerrjes së vendimit nr. 5, datë 30.09.2019, të ZVA Klos për mosmiratimin e listës organike të shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos në lidhje me ankuesin, duke urdhëruar Drejtorinë e shkollës që të marrë masa për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. ZVA Klos, si më lart janë cituar procedurat konkrete të ndjekura prej saj, ka proceduar me zënien e vendit të punës së ankuesit. Pra me veprime konkrete edhe ZVA Klos është përgjegjëse për sjelljen diskriminuese ndaj ankuesit.

Përfundimisht, sa më sipër Komisioneri konstaton se ZVA Klos dhe Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos, kanë diskriminuar ankuesin E.N në të drejtën e tij për punësim dhe për rrjedhojë kanë shkelur dispozitat e Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”. Bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se : “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës. Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit, pasi me kushtin që të paguajë dëmshpërblimin për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë, sipas parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës, ai mund të largojë çdo punonjës bazuar në një shkak të mbrojtur nga legjislacioni.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.N, në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Klos dhe Shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos.
2. Në referim të pikës 1, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos dhe Zyra Vendore Arsimore Klos, të marrin masa, sipas kompetencave respektive për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin E.N në pozicionin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Shkolla 9-vjeçare “Tahir Hoxha” Klos dhe Zyra Vendore Arsimore Klos, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit për shkak të bindjeve politike.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)

(Fusha: Punësim)